

VENDIM
Nr. 35, datë 16.1.2013

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME PËRFAQËSUES NË EKIPI TRAJNUES TË KOMANDËS SË FORCAVE SPECIALE TË NATO-S, NË QENDRËN E TRAJNIMIT TË POLICISË SPECIALE AFGANE, NË KOMANDËN RAJONALE LINDORE NË WARDAK, AFGANISTAN, NË KUADËR TË OPERACIONIT USHTARAK “ISAF”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5 e 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e 5 (pesë) përfaqësuesve ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në ekipin trajnues të Komandës së Forcave Speciale të NATO-s, në Qendrën e Trajnimit të Policisë Speciale Afgane, në Komandën Rajonale Lindore në Wardak, Afganistan, në kuadër të operacionit ushtarak “ISAF”.

2. Misioni i përfaqësuesve ushtarakë, në përbërje të ekipit trajnues të Komandës së Forcave Speciale të NATO-s, është mbështetja me trajnim, këshillim, zhvillim dhe pjesëmarrje në kryerjen e operacioneve luftarake dhe mbështetëse speciale të Qendrës së Trajnimit të Policisë Speciale Afgane, në Komandën Rajonale Lindore në Wardak, Afganistan, me qëllim sigurimin dhe mbështetjen e ecurisë së operacioneve speciale të Policisë Speciale Afgane, si dhe personelit të forcave speciale të aleancës në mbështetje të operacionit ushtarak “ISAF”.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri në 2 (dy) vjet, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të 5 (pesë) përfaqësuesve të parë ushtarakë në Afganistan. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me përfaqësuesit e radhës.

4. Ministria e Mbrojtjes të përballojë për 5 (pesë) përfaqësuesit ushtarakë pjesëmarrës në këtë operacion shpenzimet për:

a) shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) mbështetje shëndetësore;

ç) shërbim telefonik dhe internet;

d) transport;

dh) transportimin e individëve të shkëputur të misionit për në atdhe, në raste vdekjeje ose sëmundjeje;

e) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

5. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

6. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara, për çdo vit, në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha